

20030721560

L I G J I
PËR GARANCINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SIPAS MARRËVESHJES PËR
HUA TË LIDHUR NDËRMJET BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM DHE SH.A. ELEKTROEKONOMIA E MAQEDONISË PËR REALIZIMIN
E PROJEKTIT PËR NDËRTIMIN E LARGPËRÇUESIT PREJ 400 KV PREJ SHTIPI
(REPUBLIKA E MAQEDONISË) DERI NË CËRVENA MOGILLË (REPUBLIKA E
BULLGARISË)

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton përmbushjen e obligimeve sipas Marrëveshjes për hua për realizimin e Projektit për ndërtimin e largpërçuesit prej 400 kv, prej Shtipi (Republika e Maqedonisë) deri në Cërvena Mogillë (Republika e Bullgarisë), që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë, në shumën prej 40.470.600 euro.

Neni 2

Të gjitha obligimet financiare nga Marrëveshja për hua nga neni 1 të këtij ligji, si edhe servisimin e huasë do t'i përmbushë Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë nga të hyrat që i realizon, në afatet dhe kushtet e parapara me Marrëveshjen për hua.

Neni 3

Huaja nga neni 1 të këtij ligji do të paguhet si vijon:

Afati i pagimit është 15 vjet me grejs periudhë prej 4 vjetësh dhe shkallë varibile kamatore – EURIBOR gjashtëmujor plus 1 përqind.

Huaja do të paguhet në kiste të njëjta gjysmëvjetore që arrijnë për pagim më 30 maj dhe 30 nëntor të çdo viti, duke filluar prej 30 majit të vitit 2007 deri më 30 nëntor të vitit 2018.

Pas efektivitetit të huasë, Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë për administrim me huanë do të paguaj provizion të njëhershëm prej 1% dhe 10.000 euro shpenzime për shërbime juridike, ndërsa në pjesën e patërhequr të mjeteve do të paguhet provizion vjetor prej 0,5%.

Neni 4

Në qoftë se obligimet e arritura në bazë të kamatës dhe kryegjësë, në afatet e përcaktuara me Marrëveshjen për hua, në emër të Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë i paguan Republika e Maqedonisë, Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë, detyrohet që brenda 30 ditësh, nga dita e realizimit të obligimit, të derdhë në dobi të llogarisë të të hyrave të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, mjete në denarë në lartësi të pagimit të realizuar, të rritur për sasinë e kamatës të përlllogaritur dhe për shpenzimet e krijuara në lidhje me transaksionin përkatës.

Ministria e Financave mund t'i urdhërojë Drejtorisë të të Hyrave Publike bllokimin e mjeteve të Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë, mbi bazë të kthimit të TVSH-së, me qëllim që të përmbushen obligimet e arritura ndaj kreditorit, gjegjësisht shtetit t'i kompensohen mjetet në denarë në lartësi të pagimit të realizuar, të rritur për sasinë e kamatës të përlllogaritur dhe për shpenzimet e krijuara lidhur me transaksionin përkatës.

Neni 5

Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë në tërësi do ta realizojë projektin në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në territorin e Republikës së Bullgarisë.

Rregullimi i të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella lidhur me realizimin dhe arkëtimin e pjesës së projektit që do të ndërtohet në territorin e Republikës së Bullgarisë, Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë dhe Kompania Nacionale Elektrike e Bullgarisë, do ta rregullojnë me lidhjen e: Marrëveshjes për koordinimin e ndërtimit, Marrëveshjes për dërgimin e energjisë elektrike dhe Protokollin koordinativ operacional.

Neni 6

Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë prej të hyrave vetjake do të sigurojë mjete financiare në lartësi prej 5 milionë euro, si pjesëmarrje e Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë për realizimin e pjesës së Projektit për ndërtimin e largpërçuesit prej 400 kv prej Shtipi (Republika e Maqedonisë) deri në Cërvena Mogillë (Republika e Bullgarisë) në territorin e Maqedonisë.

Neni 7

Ministria e Financave dhe Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë do të lidhin marrëveshje për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella mbi bazë të garancisë së lëshuar pranë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Neni 8

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.